



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 1.4.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.103/2016, “PËR AKUAKULTURËN””

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.103/2016, “Për akuakulturën””, në mbledhjet e tij të datës 27 mars dhe 1 prill 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Besnik BARAJ.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.103/2016, “Për akuakulturën”” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i aktivitetit të akuakulturës në kuadër të një qasje më të afërt me fusha të rëndësishme të Politikës së Përbashkët të Peshkimit të Bashkimit Evropian, siç është edhe dokumenti programatik i Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës.

Ndryshimet kryesore që sjell projektligji në legjislacionin ekzistues për akuakulturën lidhet me sa më poshtë:

- Projektligji qartëson më mirë procesin e hartimit të Zonave të Përcaktuara të Akuakulturës (ZPA) sikurse mundëson që aktiviteti i akuakulturës të zhvillohet deri në përcaktimin e zonave të destinuara për këtë qëllim. Në këtë mënyrë, qëllimi i vendosjes së pezullimit të nënshkrimit të kontratave të reja (dhe konkurrimit publik) deri në miratimin e ZPA nuk kthehet në një kosto ekonomike për bizneset dhe ekonominë shqiptare.
- Projektligji parashikon krijimin dhe funksionimin e organizatave të prodhuesve të akuakulturës, objektivat e të cilave synojnë realizimin e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës, sigurojnë që ushqimet për akuakulturën, me origjinë nga peshkimi, të vijnë nga peshkimi i menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme, përmirësojnë kushtet për vendosjen në treg të produkteve të akuakulturës, përmirësojnë performancën ekonomike të subjekteve të akuakulturës dhe qëndrueshmërinë e tregjeve, promovojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, si dhe promovojnë punësimin në zonat bregdetare dhe rurale.
- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së, si dhe me politikën e përbashkët të peshkimit.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 18 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj përafron pjesërisht rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/BE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe të akuakulturës, që amendon rregulloret nr.1184/2006/(KE) dhe nr.1224/2009/KE, si dhe shfuqizon rregulloren (KE) nr.104/2000 të Këshillit.

- ***Konsultimi publik***

Gjatë diskutimeve të këtij projektligji, Komisioni zhvilloi një seancë dëshimore me përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Akuakulturës në datën 27 mars 2019.

Përfaqësuesit e kësaj shoqate u shprehën që legjislacioni aktual i pengon ata për rinovimin e kontratave duke qenë se nuk janë miratuar akoma Zonat e Përcaktuara të Akuakulturës (ZPA), e si

rrjedhojë i çon këto subjekte drejt pezullimit të aktivitetit. Ndërkohë që këto subjekte kanë investuar dhe kanë lidhur kontrata furnizimi me klientë të ndryshëm dhe ky pezullim përbën në këtë mënyrë një kosto të madhe financiare për ta. Ata u shprehën se mendojnë që projektligji do ua zgjidhë këtë ngërç dhe nuk paraqitën asnjë vërejtje në lidhje me të.

Konkretisht, projektligji parashikon që kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Ky projektligj nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që ndryshimet që propozon projektligji do të ndikojnë në zgjidhjen e ngërçit të krijuar me veprimtarinë e akuakulturës si pasojë e mosmiratimit të Zonave të Përcaktuara të Akuakulturës në kohën e përcaktuar nga ligji.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesor të projektligjit të cilat lidhen kryesisht me krijimin dhe funksionimin e Organizatave të Prodhuesve të Akuakulturës, si dhe me dhënien e një hapësire tranzitore për zgjidhjen e një situatë bllokuese në lidhje me rinovimin e kontratave të përfunduara dhe të atyre që pritet të përfundojnë në një kohë që akoma nuk janë miratuar ZPA-të.

Gjatë diskutimeve në Komision, deputetët shprehën shqetësime në lidhje me vonesat në miratimin e Zonave të Përcaktuara të Akuakulturës dhe ndikimin që ka kjo në të gjithë procesin e lejimit të ushtrimit të veprimtarisë së akuakulturës në vend.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Gjatë shqyrtimit nën për nën Komisioni pasi u njoh edhe me propozimet e Komisionit për Integrimin Europian, vendosi t'i paraqesë seancës plenare vërejtjet si më poshtë:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr 104/2000”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32013R1379, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.354, datë 28.12.2013, fq.1-21.

2. Në nenin 3 të projektligjit i cili parashikon shtimin e nenit 44/1:

- pika 2 të riformulohet si vijon: “2. Kur është e nevojshme, në momentin e krijimit të organizatës së prodhuesve, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël.”;
- pika 3 të riformulohet si vijon: “3. Një organizatë e prodhuesve që përfaqëson aktivitetet e akuakulturës dhe të peshkimit, mund të krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës.” **dhe** të kalojë para pikës 2.

3. Në nenin 3 të projektligjit i cili parashikon shtimin e nenit 44/2,

- Në pikën 2, në fjalinë hyrëse, fjalët ”organizatat prodhuese” të zëvendësohen me fjalët ”organizatat e prodhuesve”;
- pika 3 e nenit 44/2 të riformulohet si vijon: “3. Organizatat e prodhuesve mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues”.

4. Neni 4 të riformulohet si më poshtë:

“Neni 4
Dispozitë kalimtare

1. Pezullimi i përcaktuar në pikën 3, të nenit 50 të ligjit, nuk zbatohet për instalimet, pronë ekzistuese shtetërore të akuakulturës.
2. Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së, nëse ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës bën kërkesë për zgjatje. Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të pikës 2, të nenit 25, të ligjit.
3. Kontratat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni mbeten të vlefshme deri në përfundimin e ciklit të prodhimit, por jo më shumë se 18 muaj nga miratimi i ZPA-së.”

• ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për nxitejen e nivelit të bashkëpunimit të operatorëve prodhues, që do të shërbejë si një mundësi më e mirë drejt një industrie konkurruese dhe të qëndrueshme të akuakulturës, dhe e miratoi atë në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm e u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Besnik BARAJ

Niko PELESHI

Relator

Kryetar